

VEPRIMTARIA E AWEN -  
RRJETI I FUQIZIMIT TË GRUAS  
NË SHQIPËRI

2016



## KONTRIBUTE TË AWEN NË AKTIVITETE TË NDRYSHME GJATË 2016

Programi i AWEN “Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të grave në Shqipëri” mbështetur nga Sida - Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Ky program ka si objektiv të përgjithshëm përmirësimin e pozitës dhe situatës së grave në lidhje me të drejtat e tyre në Shqipëri, nëpërmjet mbështetjes financiare për organizatat anëtare të AWEN, të fokusuar në projekte që kanë të bëjnë kryesisht me: këshillim psiko-social për gratë në nevojë, viktime të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore; strehim, rehabilitim, dhe shërbimet ri-integruese për gratë në nevojë; ndihmë ligjore falas për gratë dhe vajzat në nevojë; fushata advokuese dhe aktivitete në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave njerëzore të grave; ndërgjegjësim dhe informim i komuniteteve lokale lidhur me të drejtat njerëzore të grave.

### Si rezultat i këtij programi dhe mbështetjes së projekteve të zbatuara nga organizatat anëtare gjatë vitit 2016:

- ✓ Kanë marrë mbështetje nëpërmjet shërbimeve: akomoduese, psiko-sociale, ligjore e ri/integruese rreth **1300** vajza e gra, përfshirë edhe fëmijë;
- ✓ Janë ngritur kapacitetet e **221** përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe strukturave vendore nëpërmjet trajnimeve dhe seancave ndërgjegjësuese;
- ✓ Janë ndërgjegjësuar lidhur me të drejtat e grave dhe vajzave nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese rreth **3000 persona**, djem dhe burra, vajza dhe gra;
- ✓ Rreth **60 djem dhe burra dhunues** kanë marrë shërbime rehabilituese, kryesisht këshillim psikologjik;
- ✓ Janë pritur rreth **6000 telefonata** në Linjën e Këshillimit për Gra e Vajza dhe **rreth 1300 vajza e gra** prej tyre kanë marrë këshillim nëpërmjet telefonit.

### Një histori suksesi gjatë vitit të parë të zbatimit të programit 3-vjeçar të AWEN/Sida

Shoqata ‘Jona’ Sarandë, organizatë anëtare e AWEN, në kuadër të mbështetjes nga AWEN/Sida, i pasuroi ndërhyrjet e saj në qarkun e Sarandës, duke marrë shtysë nga roli i saj koordinues e fuqizues në Mekanizmin e Referimit të Bashkisë Sarandë. Shoqata ‘Jona’ u bë nismëtare për ngritjen e një Mekanizmi të ri Referimi për adresimin e rasteve të dhunës në familje në Bashkinë Delvinë.

## Nisma lobuese dhe advokuese gjatë vitit 2016

---

- Sugjerime dhe komente për hartimin e Strategjisë për Barazinë Gjinore dhe Planit të Veprimit 2016-2020, organizuar nga MMSR;
- Kontribute për Raport Progresin e Shqipërisë 2016, organizuar nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri;
- Pjesëmarrje dhe kontribut në dëgjuesën e Kuvendit rreth situatës së Dhunës në Shtëpinë e Fëmijës në Shkodër; <https://www.facebook.com/AwenAlbanianWomenEmpowermentNetwork/posts/961107880672886>
- Kontribut në tryezat e njëpasnjëshme të organizuara nga Këshilli i Evropës rreth funksionimit të sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe antidiskrimimit;
- Kontribut për Ligjin për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, pranë Kuvendit të Shqipërisë;
- Kontribut për Ligjin për Strehimin Social, organizuar nga Ministria e Zhvillimit Urban;
- Pjesëmarrje në vizitë studimore dhe konsultime rreth situatës së Barazisë Gjinore në Shqipëri, me Institucione të ndryshme të BE-së në Bruksel, organizuar nga Kvinna till Kvinna;
- Kontribut në kuadër të publikimit të Raport Progresit 2016 me ftesë të Komisionit Evropian;
- Takim konsultues rreth situatës së të drejtave të të drejtave të njeriut në Shqipëri, të organizuar nga Sida në Tiranë, me rastin e vizitës së Z. Johannes Oljelund, Drejtor i Përgjithshëm i Zyrës për Bashkëpunim dhe Zhvillim i Ministrisë së Jashtme Suedeze në Stokholm;
- Kontribut për raportin e vërejtjeve përmbyllëse të CEDAW, organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit;
- AWEN ishte pjesë e takimit konsultues të thirrur nga Zj. Romana Vlahutin lidhur me zhvillimet e Reformës në Drejtësi, në Zyrat e Delegacionit të BE-së;
- Kontribut lidhur me zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës në Shqipëri, në procesin e finalizimit të pyetësorit të GREVIO nga MMSR;
- Kontribut për krijimin e Koalicionit “Drejtësi për të Gjithë” si dhe pjesë e reagimeve publike të këtij koalicioni lidhur me Reformën në Drejtësi <https://www.facebook.com/pg/drejtisipertegjithe/videos/>

## Letra të Hapura drejtuar Institucioneve Qendrore dhe Vendore lidhur me çështje të lidhura me të mbijetuarat e dhunës në familje/trafikimit, për<sup>1</sup>:

---

- ✓ Marrjen e masave të nevojshme për adresimin e çështjeve të rehabilitimit psiko-social ndaj personave të paditur/dhunues;
- ✓ Planifikimin e disa çështjeve në buxhetin e vitit 2017 si detyrim ligjor i Njësive të Qeverisjes Vendore/ Bashkive;
- ✓ Zbatimin e Kodit të Transmetuesve Audio-vizivë në lidhje me publikimin e lajmeve mbi ngjarjet ku janë të përfshirë gratë dhe fëmijët viktime, drejtuar Autoritetit të Medias Vizive – AMA;

---

<sup>1</sup> | gjeni nw [www.awenetwork.org](http://www.awenetwork.org), rubrika ‘Lobim dhe Advokaci’

- ✓ Qëndrim publik lidhur me Zbatimin e Urdhrave të Mbrojtjes për Viktimat e Dhunës në Familje <https://www.facebook.com/AwenAlbanianWomenEmpowermentNetwork/posts/1131079880342351>

## Tryeza Advokuese

---

- 13 Nëntor 2016 - Në kuadër të përpjekjeve për avancimin e të drejtave të grave në Shqipëri, AWEN në bashkëpunim me organizata të tjera të shoqërisë civile organizoi një **seancë diskutimi rreth çështjeve që lidhen me të drejtat e njeriut, veçanërisht të drejtat e grave**, duke u fokusuar tek çështje të legjislacionit dhe shërbimet për vajzat e gratë. Takimi doli me sugjerime konkrete rreth ndërhyrjeve të domosdoshme në legjislacion dhe qasjes së OSHC-ve rreth kësaj teme. Kjo tryezë do të vijojë me ndërhyrje konkrete gjatë 2017;
- 31 tetor 2016: Në ditën e 16-vjetorit të Rezolutës 1325 të OKB-së, AWEN në bashkëpunim me Shoqatën e Grave me Probleme Sociale, Durrës organizoi një **tryezë advokuese me hartues të politikave në nivel kombëtar dhe përfaqësues të shoqërisë civile**. Qëllimi i tryezës ishte advokimi për hartimin e një Plani Veprimi me masa konkrete për t'u ndërmarrë nga autoritetet qeveritare për të siguruar zbatimin e Rezolutës 1325 në Shqipëri.

## Ngritje kapacitetesh

---

- Qershor 2016: **Shkëmbim eksperiencash** mes anëtareve të AWEN në Shkodër, rreth ndërhyrjeve parandaluese, rehabilituese dhe ri/integruese që ofrohen kundër dhunës me bazë gjinore;
- Maj 2016: Seancë Informuese rreth **Kartës Evropiane të Barazisë Gjinore në Nivel Vendor**, me asistencën teknike të UN Women;
- Qershor 2016; Trajnim dy-ditor me organizata anëtare rreth **EU Acqui dhe Barazisë Gjinore**, mbështetur nga Kvinna till Kvinna;
- Tetor 2016: Trajnim me punonjëset e financës të organizatave anëtare rreth procedurave financiare;
- Tetor 2016: Trajnim dy-ditor për organizata të shoqërisë civile dhe anëtarët e AWEN rreth **Financimit Publik (Crowdfunding)**, mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara;
- Nëntor 2016: Trajnim online i disa juristeve të organizatave anëtarë në fushën e **Legjislacionit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut**, me mbështetjen e Sida-s;
- Nëntor 2016: AWEN dhe disa organizata anëtare, me mbështetjen e Sida-s, u bënë pjesë e FREJA Forum e organizuar në Suedi, ku ndanë eksperiencat e tyre në çështje të të drejtave të njeriut;
- Hartimi i Planeve Strategjike dhe dokumenteve të tjerë të zhvillimit organizativ për anëtarët e AWEN, mbështetur nga Sida (në vazhdim);





## Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare:

- Tetor 2016: Pjesëmarrje në konferencën e organizuar nga WAVE- Rrjeti Evropian kundër Dhunës ndaj Grave, në Berlin, Gjermani;
- Nëntor 2016: Pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga 'Autonomous Women's Center', Beograd, lidhur me zbatimin e Konventës së KE-së kundër Dhunës ndaj Grave<sup>2</sup>, ku AWEN prezantoi situatën e zbatimit të Konventës në Shqipëri.

## Materiale ndërgjegjësuese<sup>2</sup>:

- Përgatitja dhe shpërndarja elektronike e një fletëpalosje informuese rreth Ngacimit Seksual në Vendin e Punës;
- 8 Mars 2016: Përgatitja e një videoje ndërgjegjësuese lidhur me rolin e djemve dhe burrave në arritjen e barazisë gjinore, përgatitur me mbështjen e Sida - Agjensia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Spoti u shpërnda masivisht në mediat sociale, si dhe u transmetua në Report TV dhe TVSH;

<sup>2</sup>I gjeni nw [www.awenetwork.org](http://www.awenetwork.org), tek Rubrika 'Lobim dhe Advokaci'

- 12 Tetor 2016: Përgatitja e një videoje sensibilizuese rreth rolit të burrave si baballarë, lançuar në Ditën Ndërkombëtare të Baballarëve dhe prodhuar me mbështetjen e Ambasadës Amerikane;
- 25 Nëntor 2016: Përgatitja dhe shpërndarja e një videoje ndërgjegjësuere rreth dhunës në familje, mbështetur nga Ambasada Amerikane në Shqipëri. Spoti u transmetua në Report TV dhe TVSH.

## Botime

---

- Përgatitja e një raporti përmbledhës rreth zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës gjatë vitit 2016, mbështetur nga Kvinna till Kvinna; (E gjeni në [www.awenetwork.org](http://www.awenetwork.org))

**AWEN falenderon të gjithë bashkëpunëtorët për kontributin e tyre në mbështetje të grave e vajzave në të gjithë Shqipërinë gjatë vitit 2016!**

